



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:003763

Datë: 17.06.2022

Numri i dokumentit: 03143849

P.nr.1/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, me gjyqtarin Lulzim Paçarizi, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Hatixhe Begaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S. R., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së., i akuzuar sipas aktakuzës së PTH-Gjakovë PP/II.nr.1711/21 të dt.06.01.2022, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar të dt.14.06.2022, në prezencën e Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, të akuzuarit S. R. me mbrojtësinë e tij av.Jonuz Bugari me autorizim, gjykata me dt. 16.06.2022 merr dhe shpall, ndërsa me dt.17.06.2022 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: S. R. nga i ati F. dhe e ëma K. e lindjes Sh., i lindur me dt. ..., në Rahovec, Rr. „B. S.” nr. ..., ku edhe jeton, me nr.personal ..., shqiptar, shtetas i R të Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 22.11.2021 rreth orës 14:05 minuta në Rr.. M. në M., saktësisht tek udhëkryqi i transitit, pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit M. me peshë 38.59 gram, në at mënyrë që gjersa i pandehuri ishte me shokun e tij J. K. duke lëvizur me veturen e tipit ... me targa ..., të cilën e drejtonte i pandehuri S., të njejtit ndalen nga policia dhe pas identifikimit dhe kontrollimit, në automjetin e tij i gjejnë një qese të mbushur me substancë narkotike, një mulli për bluarjen dhe përzierjen e narkotikut si dhe dy pako me mbështjellës të letrës (r.), ndërsa në shtëpinë e tij kanë gjetur edhe një sasi tjetër të narkotikut me peshë 2.28 gram, të cilat janë sekuestruar nga hetuesit e D.-së.

- Me këto veprime kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 71, 72 dhe nenit 69 të KPRK-së si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtin e:

G J Y K O N

- Me dënimin me gjobë në lartësi prej **500 € (pesëqind) euro**, si dhe

- Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim në bazë të nenit 44 të KPRK-së lidhur me nenin 43 të KPRK-së, gjykata me propozimin e mbrojtësit, ka zëvendësuar dënimin me burgim në dënim me gjobë në shumën prej **2000 (dymijë) euro**.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-74) gjykata të e gjykon me **DËNIM UNIK**:

DËNIMIN ME GJOBË në shumën prej 2500 (dymijë e pesëqind) euro, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën e mbetur, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 125 (njëqind e njëzetë e pesë) ditësh, duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro për një ditë burgu.

- Konfiskohen substancat narkotike të llojit marhuanë me peshë 38.59 gram dhe një mulli për bluarjen dhe zierjen e narkotikut si dhe dy pako me mbështjellës të letrës, konform nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës të ia paguajnë shumën prej 30.00 euro, si dhe shumën prej 30.00 euro për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1711/21 të dt.06.01.2022, e ka akuzuar S. R., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 14.06.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Anton Hasanaj, si dhe i akuzuari S. R. me mbrojtësinë e tij av.Jonuz Bugari, me autorizim në shkresat e lëndës, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari S. R., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilin jam penduar thellë, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. R., Av.Jonuz Bugari gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: Meqenëse i mbrojturi im këtu i akuzuari S. R. në mënyrë vullnetare pas konsultimit paraprak e pranoj fajësinë me dëshirë, pa presion, duke i kuptuar efektet e pranimit të fajësisë, kërkojmë nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e matjes dhe shqyrtimit të dënimit, ti shqiptohet një dënim më i butë, pasi që i ka edhe kushtet e vështira ekonomike, po ashtu edhe është mbajtës i familjes ku prindin e ka me tretman të vazhdueshëm mjekësor ku është në dializë, për çka edhe gjykatës ia ofrojmë raportet mjekësore, i njëjti ka ra ndesh me ligjin për herë të parë, ku edhe premtim se ne të ardhmen do të jetë me i kujdesshëm që mos të kryej

kurrfarë veprë penale, po ashtu i propozojmë gjykatës që në rast të shqiptimit të dënimit me burg ti zëvendësohet dënimi me gjobë.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoj fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, po ashtu në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, substancat narkotike të llojit marihuanë me peshë 38.59 gram dhe një mulli për bluarjen dhe zierjen e narkotikut si dhe dy pako me mbështjellës të letrës, të konfiskohen.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar, i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari S.R. me dashje ka kryer veprën penale të posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.”

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, ngase në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr.06/L-074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, punëtor, kushtet e dobëta ekonomike, mbajtës i familjes prej ... anëtarësh, gjykata ka marrë në konsideratë edhe nenet 71 dhe 72 të KPRK-së (Kodi nr. 06/L-074), duke e zbutur dënimin nën minimumin e paraparë me ligj pasi që i akuzuari është mbajtës edhe i prindërve dhe të njëjtit janë në kujdes mjekësorë të vazhdueshëm, ku prindin e ka në dializë, si dhe është i pa dënuar më parë, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sjellja e tij korrekte në shqyrtim, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashhtë) muajsh si dhe dënimin me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, ku dënimi me burgim iu zëvendësua në dënim me gjobë në shumën prej 2000 (dymijë) euro, e që konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-74) gjykata të akuzuarit S. R. i shqiptojë dënimin unik me gjobë në shumën prej 2500 (dymijë e pesëqind) euro të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, me çka do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi konfiskimin e substanca narkotike është marr konform nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.1/2022, me dt.16.06.2022.

Bashkëpunëtore profesionale
Hatixhe Begaj

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.